



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 87A/5 Prot.

Vlorë, më 01.07.2019

**VENDIM**

**Nr. 28, datë 01.07.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MASËN 20 PËR QIND PËR PËRSHTATJE SIPAS VKM NR. 41, DATË 24.01.2018 NË PROGRAMIN E STUDIMIT "MASTER I SHKENCAVE NË PËRKTIM DHE INTERPRETIM"**

Mbështetur në pikën 9 të nenit 35, shkronjën dh të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 01.07.2019

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja për ndryshime në masën 20 për qind për përshtatje sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 në programin e studimit "Master i shkencave në përkthim dhe interpretim" si më poshtë:
  - a. Për veprimtaritë formuese nën "Lëndët plotësuese" që kanë aktualisht 16 kredite (CSE 540 *Teknologjia në përkthim*, 6 kredite dhe MTI 543 *Praktikë profesionale*, 10 kredite), MTI 543 *Praktikë profesionale* të ketë 6 kredite në mënyrë që numri i krediteve për këto veprimtari të jetë 10% (12 kredite) në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018.
  - b. Për veprimtaritë formuese nën "Detyrimet përmbyllëse" që kanë aktualisht 20 kredite (MTI 544 *Teza e diplomës*, 20 kredite), MTI 544 *Teza e diplomës* të ketë 18 kredite në mënyrë që numri i krediteve për këto veprimtari të jetë 10%-15% (12-18 kredite) në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018.
  - c. Kreditet që zbriten (6) të propozohen si lëndë e re me emërtimin ENG/ITA 501 *Studime evropiane* (6 kredite), e cila i shtohet lëndëve karakterizuese të programit.
2. Këto programe studimi do të zbatohen për vitin akademik 2019-2020.
3. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

